

Grabitja e kompetencave të Presidentit

[Gazeta Shqiptare, 4.3.2006]

“Nuk ka asnjë problem me grabitje të kompetencave të Presidentit; thjeshtë, para se t’ia çoj “unë-atij” për miratim, propozimin “tim” për ambasadorët, do të kemë marrë “unë” paraprakisht agrémentin (pranimin paraprak) nga vendi përkatës,”—tha pak a shumë kryeministri ynë aktual. U fol edhe për anashkalimin e Kuvendit, e komisionit të jashtëm të tij, por nuk po ndalojmë tek kjo, që mos t’i ikim temës kryesore. Përmendi edhe “konventën e Vjenës” (?!), siç e bën rëndom kur do të trullosë publikun, me gjëra “misterioze”, që nuk kanë pse t’i dinë të gjithë. E gjitha kjo, na duket se, përveç të tjerave, ka potencial për incidente diplomatike, që nuk janë parashikuar nga kryeministri, në ngutim dhe yryshin e tij për të grabitur kompetencat e Presidentit të Republikës.

Ndryshimi i procedurave

Procedura për ambasadorët, deri para disa ditëve, bëhej në rrugën që vijon: Ministria e jashtme (MJ) propozonte; kryeministri e miratonte; komisioni i jashtëm i Kuvendit dëgjonte kandidatët për ambasadorë, dhe jepte mendimin e tij; të gjitha këto i shkonin Presidentit, dhe ai e miratonte ose jo ambasadorin. Natyrisht, para se të bëhej gati për t’u nisur ambasadori, pyetesh vendi ku do të shkonte, nëse e pranonte (kërkohej agrémenti nga vendi përkatës). Pastaj presidenti firmoste letrat përcjellëse të ambasadorit (kredencialet). Kjo rrugë, ishte saksionuar me një vendim qeverie, që nga fillimi i vitit 2004, e procedura ishte standard, si në shumicën e vendeve përreth.

Procedura tani është bërë si vijon: kryeministri, nëpërmjet MJ, pyet shtetin përkatës, dhe pasi i vjen agrémenti "paraprak", ia shpie presidentit për t’i vënë një firmë.

Bllofi me “konventën e Vjenës”

“Konventa e Vjenës”, konventa e vitit 1961 (Vienna Convention on Diplomatic Relations and Optional Protocols/ Vienna, on 18 April 1961)—besojmë se për këtë ta ketë patur fjalën, se janë edhe disa konventa të tjera, të gjitha të Vjenës! Rezulton se në këtë konventë, nuk ka asnjë klauzolë që të detyrojë shtetet, që kërkesa për pranimin e kandidatit për ambasador (kërkesa për agrément), duhet të burojë nga kryeministri, dhe jo nga presidenti! Bile mund të thuhet se indirekt rezulton të jetë e kundërta, meqë në Konventë (neni 14) thuhet shprehimisht se ambasadorët janë të akredituar tek kryetarët e shtetit” (“Heads of State”, i cili, fatkeqësisht për kryeministrin tonë, është presidenti, dhe jo më ai personalisht!), e prandaj burimi i të gjithave, duhet të ishte presidenti, gjë që është trupëzuar edhe në nenin 92, pikat “dhe” dhe “e” të Kushtetutës sonë. Nejse, mos të zgjatemi me interpretime të procedurave, por ama një gjë është krejtë e sigurtë e nuk do interpretim: nuk qëndron se e kërkuaka kjo “konvetë e Vjenës”, e prandaj po u ndryshuaka procedura ekzistuese—pra kjo me konventën, duket si bllofi i radhës: ta hajë kush ta hajë.

Potencial incidentesh diplomatike

Kryetari i shtetit, është ai që jep pranimin (agrémentin) e kandidatit për ambasador të një shteti të huaj, e kjo në shumë shtete. Le të marrim për analogji Slloveninë, që është një shtet i Ballkanit Perëndimor, si dhe ne, por që praktikisht po hyn në Bashkimin Evropian, kurse ne jemi akoma shumë larg. Do të shpjegojmë dy nga shumë incidente diplomatike që mund të shkaktojë ndryshimi i procedurave tona.

Incidenti i parë: Merret agrémenti nga vendi i huaj, por abasadori ynë nuk dërgohet, sepse nuk e miraton presidenti. E zëmë se kryeministri ynë kërkon agrémentin në Slloveni, për kandidatit për amabasador të zgjedhur prej tij, p.sh. z. Alia. Sipas aktit normativ slloven (Foreign affairs act—

ZZZ-1), është presidenti i Sllovenisë ai që do të jepte miratimin (agrémentin), pavarësisht se përdoren kanalet e MJ. Kur bëhet gati z. Alia për në Slloveni, presidenti Moisiu nuk e miraton dërgimin e tij. Slloventët presin z. Alia, por ai nuk arrinë kurrë. Si do të justifikoheshim para Sllovenisë?! Nuk u dërgon dot shteteve të huaja, sot një emër, e nesër një tjetër, derisa të merret vesh kryeministri ynë me presidentin! Nuk bëhen kështu punët, sepse nuk e kanë për gjë të të përgjigjen: “nuk kemi kohë të merremi me ju”.

Incidenti i dytë: *Kryeministri ynë jep agrémentin, dhe kur vjen ambasadoja e huaj, presidenti ynë e përze, e quan “persona non grata”.* E zëmë se Sllovenisë, sipas Konventës së Vjenës të vitit 1961 (neni 4), i është dhënë agrémenti për kandidaten e saj për ambasadore në Tiranë, znj. Harxhiq. Por ky agrément, nuk i është dhënë nga presidenti ynë, por nga kryeministri ynë. Presidenti i Sllovenisë, me të drejtë, e nisë znj. Harxhiq. Por sapo ambasadorja sllovene arrin në Tiranë, që të paraqesë tek presidenti ynë kredencialet, presidenti ynë e refuzon—ku pyet ai se kryeministri ynë i paska dhënë agrémentin “paraprak”; dhe ka të drejtë të mos pyes, se me presidentin është Kushtetuta jonë! Pak rëndësi ka këtu se përse e refuzon presidenti ynë znj. Harxhiq (p.sh. sepse ajo ka bërë veprimtari antishqiptare, duke përzgjedhur nga shtypi botëror, vetëm shkrimet më negative e të mbushur me shpifje për Shqipërinë). Natyrisht, me që nuk ekziston në botë nonsensi “agrément paraprak” (se vetë agrémenti është pranim paraprak, ku ta dinë ata se ne këtej nga Shqipëria kemi klasifikime të veçanta), refuzimi i ambasadores do të ishte një incident diplomatik, që e pakta do na nxirrte jo seriozë në sytë e botës: përse e dhanë xhanëm agrémentin, kur nuk e donin atë zonjë?!

Bllofi për të huajt mund të mos ecë

Mbase nuk do t’u shkojë ndër mend të huajve, se kërkesa për agrément, nuk buron nga presidenti ynë, dhe se presidentit tonë do t’i vij zor ta refuzojë ambasadoren—kjo duket është ajo që shpreson kryeministri ynë aktual. Vërtetë që mund t’i ecte një blluf i tillë. Por po sikur të ndodhë që nuk i ecën?! P.sh., kur të pyetet Sllovenia,—e panoni z. Alia për ambasador?—ajo të thotë,—kush po pyet, kryeministri apo presidenti? E pastaj, të përgjigjet: “Nuk jep presidenti ynë agrément për një person që nuk është kaluar në Shqipëri, në një filtër të plotë, me presidentin, dhe jo vetëm me kryeministrin”—prapë, sa turp do të ishte! E ta do mendja, se dhënia e agrémentit nga shtetet, varet edhe nga fakti se në ç’filtra ka kaluar kandidati për ambasador.

* * *

Këto që po bëhen, e që ne po na duken grabitje, potencial për incidente diplomatike, bllufe dhe mashtrime me të huajt e edhe me ne të brendshmit, të gjitha këto i paguajmë secili prej nesh shqiptarëve, dhe jo vetëm Ai që po i bën, prandaj bëjmë mirë të jemi të vëmendshëm.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 28.2.2006